

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 7
09.02.2011

NR. VENDIMI 3
24.03.2011

V E N D I M

“Per pezullim mase sekuestroje”

Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë e përbëre prej:

BARDHYL DHAMA – GJYQTAR

Asistuar prej sekretares së seancës gjyqësore **Fjoralba Kola**, sot më datë 24.03.2011, mori në shqyrtim kërkesën penale nr.07 akti të paraqitur prej:

KËRKUES: E. Gj., i biri i H. dhe T., dtl.xx.xx.xxxx, lindur e banues ne xxxxx, me shtetesi e kombesi shqiptare, perfaqsuar ne gjykim me autorizimin dt.xx.xx.xxxx nga Av. E. K. dhe Av. E. M. Dhoma e Avokatise Tirane.

KUNDER : Prokurorise Prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, e perfaqsuar ne gjykim nga prokurori A. Xh..

ME OBJEKT : Pezullim i mases se sekuestros ndaj pasurive, aktivitetit dhe cdo te drejte te shoqerise B.S A (BSA).

BAZA LIGJORE : Neni 5/3 I Ligjit nr. 10192 dt.03.12.2009 “ Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, vendimi nr.37 dt.25.11.2010 I Gjykates

se Apelit per Krime te Renda Tirane.

Gjykata pasi celi shqyrtimin gjyqesor, degjoi perfaqsesen e kerkuesit ne parashtrimin e saj, degjoi prokurorin ne parashtrimin e tij, administroi provat e paraqitura nga palet, degjoi palet ne konkluzionet e tyre perfundimtare ku perfaqsesja e kerkuesit E. Gj., kerkoi te pranohet kerkesa per pezullim te mases se sekuestros te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr. 12 dt. 07.10.2010, degjoi prokurorin i cili kerkoi te pranohet kerkesa per pezullim te mases se sekuestros te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr.12 dt. 07.10.2010.

Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen:

VEREN se

Kerkesa e paraqitur nga shtetasi E. Gj. , per pezullim te pasojave te zbatimit te mases se sekuestros te vendosura nga kjo gjykate me vendimin e saj nr.12 dt.07.10.2010, eshte e drejte , e bazuar ne ligj e ne prova dhe se ajo duhet te pranohet.

Kjo gjykate me vendimin e saj nr.12 dt.07.10.2010, ka gjykuar kerkesen e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane per vendosje te mases se sekuestros bazuar ne ligjin nr. 10192 dt.03.12.2009, e midie te tjerave per sa i perket pasurive te kerkuesit E. Gj , ka vendosur : vendosjen e sekuestros mbi pasurine, aktivitetit të shoqërisë anonime “xxxxxx xxxxxx xxxxxx”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqërie në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 01/03/2010, me numër NIPTI xxxxxxxx, me datë themelimi 12/02/2010, me kohëzgjatje deri me 12/02/2060, me Seli në xxxxx, Rruga e xxxxxxx, tek ProCredit Bank-Laprake, me kapital fillestar xx.xxx.xxx lekë, me objekt “Sherbime në software, nëpërmjet internetit, për parashikimin e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove, basteve, garave të ndryshme të të gjitha llojeve, prodhim i materialeve, lëndëve të para dhe prodhim i makinave elektronike të lojërave të fatit. Zhvillim i lojërave të fatit, lojrat aritmetike, lotot, keno, bingo, proto, xhoker, baste, llotari, lojera elektronike, lojera fati sportive të cilat janë, konkurs për parashikimet sportive të të gjitha lojrave sportive si ato që luhen me këmbë, me dorë, në ujë, për gjetjen e rezultateve, të ndeshjeve të futbollit, ose lojërave të tjera sportive të të gjitha llojeve, kazino”. Ky vendim ka mbetur i pacenuar ne gjykatat me te larta.

Me kërkesen drejtuar gjykates, kerkuesi E. Gj , nepermjet perfaqsesve te tij, bazuar ne nenin 5/3 te ligjit nr. 10192 dt. 03.12.2009, ka kerkuar pezullimin e mases se sekustros mbi pasurite e tij, te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr. 12 dt. 07.10.2011. Kete kerkese te tij per pezullim te mases se sekuestros, kerkuesi E. Gj e bazon ne faktin se per keto pasuri te sekuestruara nga kjo gjykate me vendimin nr. 12 dt. 07.10.2010 bazuar ne ligjin nr. 10192 dt. 03.12.2009, eshte marre masa e sekuestros nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, bazuar ne nenet 208, 210 te K.Pr.Penale per llogari te procedimit penal nr.1516 vitit 2010 te regjistruar nga kjo prokurori.Ne keto rrethana bazuar ne parashikimin e nenit 5/3 te ligjit nr. 10192 dt.03.12.2009 dhe arsyetimin e bere nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane ne vendimin e saj nr.37 dt.25.11.2010, kerkuesi E. ka kerkuar pezullimin e mases se sekustros mbi pasurite e tij, te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr. 12 dt. 07.10.2011 pasi te njejtat pasuri i jane nenshtuar sekuestrimit sipas Kodit te Procedures Penale.

Prokurori ne seance, pasi u njoh dhe me vendimet e sekuestros te vendosura nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore per llogari te procedimit penal nr.1516 te vitit 2010 te regjistruar nga kjo prokurori, ishte dakort me kërkesen e paraqitur nga kerkuesi E. Gj. , dhe bazuar ne nenin 5/3 te ligjit nr.10192 dt.03.12.2009, kerkoi te pezullohet zbatimi i mases se sekustros mbi pasurite e kerkuesit, te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr. 12 dt. 07.10.2011.

Lidhur me sa u kerkua dhe u pretendua nga palet ne kete gjykim, gjykata vlen te theksoje se:

- 1- Me vendim nr.12 dt.07.10.2010, kjo gjykate ka vendosur sekuestron mbi pasurine, aktivitetit të shoqërisë anonime “**xxxxxxx xxxxxxxx xxxxxxxx**”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqërie në Shqipëri, shoqëri e cila është regjistruar me datë 01/03/2010, me numër NIPTI xxxxxxxxxxxx, me datë themelimi 12/02/2010, me kohëzgjatje deri me xx/xx/xxxx, me Seli në Tirane, Rruga e xxxxxxxx, tek ProCredit Bank-xxxxxx, me kapital fillestar 20.000.000 lekë, me objekt “Sherbime në software, nëpërmjet internetit, për parashikimin e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove, basteve, garave të ndryshme të të gjitha llojeve, prodhim i materialeve, lëndëve të para dhe prodhim i makinave elektronike të lojërave të fatit. Zhvillim i lojërave të fatit, lojrat aritmetike, lotot, keno, bingo, proto, xhoker, baste, llotari, lojera elektronike, lojera fati sportive të cilat janë, konkurs për parashikimet sportive të të gjitha lojrave sportive si ato që luhen me këmbë, me dorë, në ujë, për gjetjen e rezultateve, të ndeshjeve të futbollit, ose lojërave të tjera sportive të të gjitha llojeve, kazino”. Ky vendim ka mbetur i pacenuar ne gjykatat me te larta.

- 2- Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, ne dt. 01.10.2010 eshte regjistruar procedimi penal nr.1516 per vepren penale te “ Pastrimit te produkteve te vepres penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Per llogari te ketij procedimi penal, kjo prokurori ka marre dy vendime per sekuestrim sendesh: a- vendimi per sekuestrim sendesh i dt. 06.10.2010 ku eshte vendosur sekuestroja ne Bangen xxxxx mbi llogarite bankare te shoqerive xxxxx xxxxx xxxxxx, xxx xxxx, dhe te shtetasve A. P. dhe E. Gj. Ky vendim eshte ende ne fuqi pasi nuk eshte cenuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore me vendimin e saj nr.427 dt.01.11.2011 si dhe nga vendimi nr.206 dt. 07.12.2010 i Gjykates se Apelit Vlore. b- vendim per sekuestrim sendesh i dt. 06.10.2010, ku eshte vendosur sekuestroja mbi ambientet e shoqerise xxxxx xxxxx xxxxxx me adrese ne xxxxx, Rruga e Durresit tek ProCredit Bank Tirane si dhe ne cdo filial apo zyre te kesaj shoqerije, sendet qe ndodhen ne keto ambiente. Ky vendim eshte ende ne fuqi pasi nuk eshte cenuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore me vendimin e saj nr.429 dt.01.11.2011 si dhe nga vendimi nr.205 dt.07.12.2010 i Gjykates se Apelit Vlore.
- 3- Sipas shkreses dt.ska, te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, rezulton se pas shpalljes se moskompetences se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore per procedimin penal nr.1516 te vitit 2010, ky procedim penal eshte regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore me nr.4632 per veprat penale te parashikuara nga nenet 287, 181, 197, te K.Penal ne ngarkim te shtetasve E. Gj. etj. Pas kerkeses te bere nga gjykata, me shkresen nr.2357/1 dt.24.03.2011 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane ku eshte kthyer pergjigje, rezulton se dy vendimet e sekuestros te dt.06.10.2010 te marre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore jane ende ne fuqi, ne zbatim.

Per sa u parashtua me lart, rezulton qe mbi pasurine e kerkuesit E. Gj , momentalisht dhe njekohesisht ekzistojne dy lloj vendime sekuestroje, 1)-vendimi i kesaj gjykate nr. 12 dt. 07.10.2011(ende ne fuqi), per vendosje sekuestroje bazuar ne ligjin e posacem nr. 10192 dt.03.12.2009; dhe 2)- dy vendime sekuestroje te dt.06.10.2010 (ende ne fuqi), per vendosje sekuestroje bazuar ne nenet 208, 210 te K.Pr.Penale.

Ne nenin 5 te ligjit nr. 10192 dt.03.12.2009, eshte parashikuar maredhenia e masave parandaluese(sekuestro, konfiskim) te vendosura sipas ketij ligji, me procedimin penal. Ne paragrafin e trete te nenit 5 te ligjit te mesiper, eshte sanksionuar se : Ne rastet kur pasurite e sekuestruara apo konfiskuara, sipas ketij ligji, i nenshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit te Procedures Penale, gjykata urdheron pezullimin e pasojave te zbatimit te masave te sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas ketij ligji. Pezullimi perfundon me dhenien e nje vendimi gjyqesor penal per revokimin apo shuarjen

e ketyre masave.

Sipas parashikimit te kesaj dispozite, rezulton se ne rastet kur kemi ekzistence, gjendje, te masave parandaluese mbi pasurine (sekuestro, konfiskim), te vendosura keto dhe sipas ligjit te posacem nr.10192 dt. 03.12.2009 dhe sipas Kodit Penal apo Kodit te Procedures Penale, ato nuk mund te zbatohen qe te dyja njekoheisht, por do te kene perparesi, prevalence zbatimi, masat e sekuestros, konfiskimit te vendosura sipas Kodit Penal apo Kodit te Procedures Penale. Zbatimi i masave parandaluese mbi pasurine, te vendosura sipas ligjit te posacem nr.10192 dt.03.12.2009, duhet ti pezullohet pasoja, deri ne dhenien e nje vendimi gjyqesor penal per revokim apo shuarje te ketyre masave te vendosura sipas Kodit Penal apo Kodit te Procedures Penale.

Bazuar ne parashikimin e mesiperm te nenit 5/3 te ligjit nr.10192 dt.03.12.2009, gjykata cmon se mases se sekuestros, te vendosur me vendimin e kesaj gjykate nr.12 dt.07.10.2010, duhet ti pezullohen pasojat e zbatimit per ato pasuri, per te cilat eshte vendosur njekoheisht dhe masa e sekuestros nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore me vendimet perkatese dt. 06.10.2010, te marra bazuar ne Kodin e Procedures Penale e te vendosura per llogari te procedimit penal te regjistruar. Ky pezullim do te perfundoje ne momentin e denies se nje vendimi gjyqesor penal apo nje vendimi te mundshem te organit te prokurorise, per revokimin apo shuarjen e ketyre masave. Per kete qellim, nje kopje e ketij vendimi, gjykata cmon qe ti njofohet Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane si prokuroria kompetente aktualisht, si dhe ti kerkohet kesaj prokurorie, qe te njoftoje kete gjykate lidhur me ecurine, fatin e dy masave te sekuestros te dt.06.10.2010 te marre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, deri ne perfundim te procedimit penal te regjistruar apo gjykimit.

PER KETO ARSYE

Gjykata duke pare nenin 5/3 te ligjit nr.10192 dt.03.12.2009, nenet 306, 310 te K.Pr.Civile

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses.

Pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se sekuestros, te vendosura nga kjo gjykate me vendimin nr.12 dt.07.10.2010, mbi keto pasuri:

- a- Ambientet e shoqerise B.S.A. xxxxx xxxxx xxxxx sh.a., me adrese ne Laprake, Rruga e Durrës tek ProCredit Bank Tirane si dhe ne cdo filial

apo zyre te kesaj shoqerije, sendet qe ndodhen ne keto ambiente.

b- Llogarite bankare ne Bangen CREDINS, ne emer te shoqerise xxxxx
xxxxx xxxxxx sh.a. (B.S.A.), si dhe ne emer te shtetasit E. Gj.

Nje kopje e ketij vendimi ti njoftohet Agjensise per Administrimin e Pasurive
te Sekuestruara dhe Konfiskuara prane Ministrise se Financave.

Nje kopje e ketij vendimi ti njoftohet Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane,
me detyrimin e saj te njoftoje kete gjykate, lidhur me ecurine e procedimit penal
nr.4632 te vitit 2010(vetem per sa I perket masave te sekuestros), deri ne marrjen
e nje vendimi gjyqesor apo nje vendimi te mundshem te saj, per sa I perket fatit te
masave te sekuestros, te vendosura nga prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore me
dy vendimet e saj te dt.06.10.2010, mbi pasurite e permendura me lart.

Shpenzimet gjyqesore sic jane kryer.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda
Tirane, Brenda afatit ligjor.

U shpall dt. 24.03.2011.

SEKRETARE
Fjoralba KOLA BARDHYL DHAMA

GJYQTAR